



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:011476

Datë: 09.10.2020

Numri i dokumentit: 01173911

P.nr.10/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues **Drilon Haraçia**, me procesmbajtësen Valbone Hoxha pranë kësaj Gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarve B. A. K. nga fsh. . . , Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së dhe të akuzuarit V. V. H. nga fsh. . . , Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 lidhur me paragrafi 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.9/20, të datës 20.01.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, seancë publike, **me datë 06.10.2020**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Armend Zenelaj si dhe të akuzuarve, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve:

B. K. nga i ati A. dhe e ëma A., e gjinisë H., data e lindjes . . . në Gjakovë, tani me banim në fsh. . . , Komuna e Gjakovës, ka kryer shkollën e mesme mjekësisë, punëtor – frizer, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar, Shqiptar, Shtetas i R. Kosovës, me numër personal . . .

V. H. nga i ati V. dhe e ëma L., e gjinisë P., data e lindjes . . . në Gjakovë, tani me banim në fsh. . . , Komuna e Gjakovës, ka kryer shkollën e mesme ekonomike, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, punëtor – në ndërtimtari, Shqiptar, Shtetas i R. Kosovës, me numër personal . . .

J A N Ë F A J T O R

I akuzuari B. K.;

Sepse me datë 03.01.2020, rreth orës 14,20 në Gjakovë, Rr. “. . .”, i pandehuri pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme, në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore dhe atë të llojit marihuan, në atë mënyrë që pasi hetuesit u afrohen një veturë të parkuar, ku brenda në veturë ishin dy persona, pasi i identifikojnë të njëjtit, fillojnë që ta kontrollojnë të pandehurin, kur tek dora e të njëjtit e gjejnë një qese najloni e mbushur me substancë në formë bari, në peshë prej 3.12 gram, ndërsa në mes të ulëseve të veturës gjejnë një cigare (joint) të mbushur me substancë në formë bari, në peshë prej 0,75 gram, substancë të cilën e i pandehuri ka pranuar që është i tij, e të cilat substanca janë sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor, e që në bazë të raportit të ekspertimit, substancat kanë rezultuar të jenë të llojit marihuan.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale: posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari V. H.;

Sepse me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin I, të kësaj aktakuzës, i pandehuri pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme, në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore dhe atë të llojit marihuanë, në atë mënyrë që pasi hetuesit fillojnë që ti kontrollojnë të pandehurit dhe veturën në mënyrën e përshkuar si më lartë, tek i pandehuri, respektivisht në xhepin e djathtë të jaknes së tij, kanë gjetur një qese najloni e mbushur me substancë në formë bari, në peshë prej 0.66 gram, e cila substancë është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor, e që në bazë të raportit të ekspertimit, substanca ka rezultuar të jetë e llojit marihuanë.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe nenit 269 par.1 dhe 2 dhe par.3 të KPRK-së, të akuzuarit i:

G J Y K O N

Të akuzuarin B. K.:

ME DËNIM ME GJOBË, në shumë prej 300.00 € (treqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

ME DËNIM ME KUSHT, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë të akuzuarit i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

Ndaj të akuzuarit **KONFISKOHET**, substanca narkotike e llojit "Marihuanë", në peshë të përgjithshme prej 3.87 gram, si objekt i veprës penale.

Urdhërohet Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e substancës narkotike, që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2020-DHTN-06.

Të akuzuarin V. H.:

ME DËNIM ME GJOBË, në shumë prej 400.00 € (katërqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë të akuzuarit i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

Ndaj të akuzuarit **KONFISKOHET**, substanca narkotike e llojit “Marihuanë”, në peshë të përgjithshme prej 0.66 gram, si objekt i veprës penale.

Urdhërohet Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e substancës narkotike, që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2020-DHTN-06.

Detyrohet të akuzuarit **B. K. dhe V. H.**, që ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor veç e veç shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit veç e veç shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.9/20, të datës 20.01.2020, ndaj të akuzuarve B. A. K. nga fsh. . . , Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së dhe të akuzuarit V. V. H. nga fsh. . . , Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. Prokurori e Shtetit Armend Zenalaj gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve, ku ka propozuar që të njëjti të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

I akuzuari B. K., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas pikës së aktakuzës dhe i njëjti shton se është i penduar për veprën penale shton se nuk jam më konsumues i narkotikëve, dhe premtoi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale, duke propozuar Gjykatës që të ketë parasysh një dënim sa më të lehtë.

I akuzuari V. H., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas pikës së aktakuzës dhe i njëjti shton se është i penduar për veprën penale shton se nuk jam më konsumues i narkotikëve, dhe premtoi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale, duke propozuar Gjykatës që të ketë parasysh një dënim sa më të lehtë.

Prokurori i Shtetit Armend Zenalaj ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, nga ana e akuzuarve B. K. dhe V. H., pasi që të njëjtit pranimin e fajësisë me vullnet dhe vetëdije të plotë, pa presion, të njëjtit paraprakisht kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë mbështetet në provat dhe faktet që përmban aktakuza, andaj propozoi gjykatës që të akuzuarit B. K. dhe V. H. të shpallet fajtor dhe të dënohen në bazë të ligjit, po ashtu të njëjtit të obligohen edhe në pagesën e shpenzimeve procedurale. Po ashtu i propozoi Gjykatës që në bazë të nenit 269 par.3 të KPRK-së, substancat narkotike të përshkruara si në dispozitivet e kësaj aktakuze të konfiskohen.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari B. K., se me datë 03.01.2020, rreth orës 14,20 në Gjakovë, Rr. “. . .”, i pandehuri pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope ose

analoge të shpallura të rrezikshme, në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore dhe atë të llojit marihuan, në atë mënyrë që pasi hetuesit u afrohen një veturë të parkuar, ku brenda në veturë ishin dy persona, pasi i identifikojnë të njëjtit, fillojnë që ta kontrollojnë të pandehurin, kur tek dora e të njëjtit e gjejnë një qese najloni e mbushur me substancë në formë bari, në peshë prej 3.12 gram, ndërsa në mes të ulëseve të veturës gjejnë një cigare (joint) të mbushur me substancë në formë bari, në peshë prej 0,75 gram, substancë të cilën e i pandehuri ka pranuar që është i tij, e të cilat substanca janë sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor, e që në bazë të raportit të ekspertimit, substancat kanë rezultuar të jenë të llojit marihuan.

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari V. H., se me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi, i pandehuri pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme, në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore dhe atë të llojit marihuanë, në atë mënyrë që pasi hetuesit fillojnë që ti kontrollojnë të pandehurit dhe veturën në mënyrën e përshkuar si më lartë, tek i pandehuri, respektivisht në xhepin e djathtë të jaknes së tij, kanë gjetur një qese najloni e mbushur me substancë në formë bari, në peshë prej 0.66 gram, e cila substancë është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor, e që në bazë të raportit të ekspertimit, substanca ka rezultuar të jetë e llojit marihuanë.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e të akuzuarve, të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurorja e shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së për hedhjen e aktakuzës përkatësisht pushimin e procedurës penale.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale: posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së dhe nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit B. K., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale për të akuzuarin: se është i moshës relativisht të re, është i gjendjes së dobët ekonomike, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt. Po ashtu si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar edhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale që ngarkohet, të cilin pranimi i akuzuarit e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës, po ashtu se i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të aktgjykimit do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe qëllimi i dënimit dhe se dënimet si të tilla i shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit V. H., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale për të akuzuarin: se është i moshës relativisht të re, është i gjendjes së dobët ekonomike, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt. Po ashtu si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar edhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale që ngarkohet, të cilin pranim i akuzuari e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës, po ashtu se i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë veprë penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të aktgjykimit do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe qëllimi i dënimit dhe se dënimet si të tilla i shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, konform nenit 269 par.3 të KPRK-së, ndaj të akuzuarve, ka konfiskuar substancën narkotike të llojit “Marihuanë”, në peshë prej 3.87 gram dhe në peshë prej 0.66 gram, pasi që e njëjta ka qenë objekt i veprës penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitivin të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

- Departamenti i përgjithshëm -

P.nr.10/20, me datë 06.10.2020

**Procesmbajtësja,
Valbone Hoxha**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Drilon Haraçia**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.